



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

## PERFORMANCA E MBLEDHJES SË TË ARDHURAVE



## RIMBURSIMI I TVSH-SË



## LUFTA KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE



## PËRSHPEJTIMI I KONKURRUESHMËRISË NË RAJON



## BASHKËPUNIMI EKONOMIK SHQIPËRI-ÇEKI



## BASHKËPUNIMI MES BIZNESEVE TË RAJONIT



## PUNËSIMI PËRMES ZYRAVE TË PUNËS



# DITARI JAVOR

17 - 23 Shkurt 2020

Të ardhurat e buxhetit të shtetit në vitin 2019 u mblodhën në masën 460 miliardë lekë, me një rritje prej 2.3% ose 10.4 miliardë lekë më shumë se vitit 2018. Kjo u bë e ditur gjatë një komunikimi që Ministria Anila Denaj zhvilloi me median dhe opinionin publik. Për vitin 2019, të ardhurat totale në përqindje të PPB kanë qënë në masën 27.4%. Ministria tha se MFE është duke punuar edhe me FMN, me një grup të posaçëm që do të analizojë rekomandimet e ardhura për sa i përket strategjisë afatmesme të të ardhurave, me objektivin që në 5 vitet e ardhshme kjo përqindje të rritet me të paktën 4%. Të ardhurat mesatare totale të Buxhetit të Shtetit, në % të PPB, për periudhën 2014-2019, janë 27.18% nga 25.3% që ishin në periudhën 2009-2013. Të ardhurat e buxhetit në raport me buxhetin fillestar janë realizuar në masën mesatare 94.6% në 2019.

Rimbursimi i TVSH-së për vitin 2019 është në vlerën e 23.5 miliardë lekë, 63% ose 9.1 miliardë lek më shumë se në vitin 2018, dhe 4.5 miliardë lekë më shumë se parashikimi fillestar. Shuma e rimbursuar e TVSH për 2009-2013 është 30.4 miliardë lekë, ndërsa për periudhën 2014-2019 kjo shumë është 54.5 miliardë lekë. Viti 2019 shënoi nivelin më të lartë historik i rimbursimit të TVSH-së në 10 vitet e fundit, periudhë gjatë së cilës kanë përfutur rreth 1360 biznese si: eksportues, fason, grumbullues, transport ndërkombëtar, etj. Stoku i rimbursimeve të padhëna është zëruar për herë të parë, për këtë kategori biznesesh. Synimi i MFE është që stoku i TVSH së parimbursuar të bëhet zero në mesin e vitit 2021, ndërsa për të gjithë bizneset e tjera nuk do të ketë asnjë ditë vonesë në rimbursimin e TVSH-së.

Ministrja Denaj mori pjesë në Seancën Plenare të Grupit të Posaçëm për Veprim Financiar, në Paris, ku informoi mbi progresin që ka bërë Shqipëria në kuadër të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Vendet anëtare të Grupit të Posaçëm të Veprimit njohën dhe mirëpritën vullnetin politik të Qeverisë Shqiptare dhe MFE për të rritur efektivitetin në këtë luftë të përbashkët. Shqipëria ka ndërmarrë një sërë hapash për të luftuar këto fenomene duke: përmbushur plotësisht ose gjerësisht 52 masat e rekomanduara nga Komiteti Moneyval; miratuar në vitin 2019 ndryshimet ligjore në 5 ligje të rëndësishme të lidhura me administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kryer ndryshimet e rregulloreve dhe procedurave të institucioneve mbikqyrëse, etj.

Ministrja Denaj, së bashku me homologët e Ballkanit Perëndimor, Forumin Ekonomik Botëror (WEF) dhe Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (RCC), prezantuan nismën për krijimin e Akseleratorit për konkurrueshmërinë dhe inovacionin në Ballkanin Perëndimor. Ministria theksoi krijimin e platformës për përshpejtimin e konkurrueshmërisë dhe inovacionit në Ballkanin Perëndimor, si një platformë e bashkëpunimit rajonal publik dhe privat. Kjo nismë synon të mbështesë Ballkanin Perëndimor në përmirësimin e ekonomisë rajonale përmes inovacionit, mbështetjes për sipërmarrjen dhe në rrugëtimin e sektorit privat drejt tregut evropian dhe më gjerë. Ministria Denaj mirëpriti iniciativën dhe theksoi se vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor duhet t'i kushtojnë rëndësi transformimit të modelit aktual të biznesit drejt modelit "të zgjuar" të së ardhmes, të orientuar drejt inovacionit, duke synuar përmirësim të konkurrueshmërisë dhe cilësisë.

Nënshkruhet në Pragë Protokollin e Sesionit të 6-të të grupit të përbashkët të punës për bashkëpunim ekonomik mes Shqipërisë dhe Çekisë. Për palën shqiptare, Protokollin u nënshkrua nga Zv. Ministria Ikonomi dhe për palën çeke nga Zv. Ministria e Industrisë dhe Tregtisë, znj. Tauberová. Protokollin përfshin çështje të bashkëpunimit ekonomik, tregtisë dhe investimeve ndërmjet dy vendeve në fusha si, infrastrukturë, industri, energji, mjedis, bujqësi, turizëm, standardizim, metrologji, etj. Dy zëvendësiministret vlerësuan bashkëpunimin e deritanishëm dhe diskutuan mbi hapat e mëtejshëm që do të ndërmerren nga të dyja palët në vijim, në fushat me interes reciprok. Përgjatë dy ditëve, ekspertët teknikë të këtyre fushave diskutuan mbi mundësitë dhe hapësirat për bashkëpunim, si dhe evidentuan mekanizmat dhe instrumentat që do të bëjnë të mundur implementimin e këtij protokollin.

Qendra Kombëtare e Biznesit i bashkohet portalit të regjistrave të biznesit të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Dokumenti u nënshkrua nga drejtoresha e QKB gjatë mbledhjes së bordit drejtues të Portalit Rajonal të Regjistrave të Biznesit, e cila në fjalën e saj theksoi se QKB vijon të mbetet e angazhuar për lehtësimin e mëtejshëm të procesit të regjistrimit të biznesit dhe për rritjen e transparencës. Projekti mundëson komunikim në kohë reale i të dhënave të besueshme, të përditësuara për të gjitha subjektet tregtare të regjistruara në regjistrat tregtare të vendeve pjesëmarrëse, si dhe mundësohet baza për krijimin e shërbimeve globale për të gjitha subjektet në shtetet palë. Gjithashtu, portali do të mundësojë ndërlidhjen e bizneseve shqiptare me ato të rajonit, duke bërë të mundur rritjen e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtarë të vendeve të rajonit.

500 është numri i personave që janë punësuar me ndërmjetësimin e zyrave të Punës gjatë periudhës 14-20 shkurt 2020. Numrin mw tw madh tw tw punësuarve e ka qarku i Tiranës me 133 persona, ndjekur nga qarku i Durrsut me 83 persona, qarku i Fierit me 55 persona, qarku i Vlorës me 52 persona, qarku i Elbasanit me 44 persona, etj.